



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 25 datë 22.02.2019

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Në Tiranë, sot më datë 22.02.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi dëgjoj në seancën plenare të datës 22.02.2019, relacionin e Komisionit të Karrierës si dhe mendimet e paraqitura nga Anëtarët e Këshillit në mbledhje

K O N S T A T O J

Prokuroria e Apelit për Korçë është themeluar dhe ushtron veprimtarinë e saj pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Kjo prokurori ka në organikën e saj dy prokuror.

Sipas njoftimit të kryer, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 19.02.2019 ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Bali, drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë”.*

Në nenin 62 me titull “Të drejtat e subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimit të Komisionit” të ligjit 84/2016 për “Rivlerësimin kalimatar të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. 2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, deri në marjen e formë së prerë të këtij vendimi, prokuroria znj. Irma Bali, është në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.*

Në kuptim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 42/2, pozicioni i lirë i sipërpërmendur konsiderohet i përkohshëm për të paktën tre muaj, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për prokurorin znj. Irma Bali.

Në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.4. Këshilli merr vendim*

për rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe përcakton datën e fillimit dhe datën e mbarimit të periudhës kohore, në të cilën pozicioni mund të plotësohet përkohësisht”.

Në nenin 59 të ligjit të sipërcituara nuk parashikohen kushtet dhe kriteret, që një prokuror duhet të plotësojë për t’u caktuar përkohësisht në një pozicion magjistrati. Bazuar në interpretimin sistematik, të dispozitave ligjore të pjesës së tretë të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“ të titulluar “Zhvillimi i karrierës së magjistratëve”, rezulton se prokurori që caktohet deri në tre muaj në një pozicion të ngelur bosh përkohësisht, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret, që kërkohen nga ligji për ushtrimin e detyrës për atë pozicion. Gjithashtu fryma e ligjit është e tillë, që lëvizjet e magjistratëve edhe përkohësisht duhet të kryhen nga Këshilli, duke pasur kujdes, që të mos dëmtohen hetimet apo proceset gjyqësore të çështjeve penale që ka në dorë prokurori, që do të caktohet përkohësisht në pozicionin e mbetur bosh.

Në rastin konkret pozicioni i ngelur bosh është përveç “Drejtues i Prokurorisë” pranë Gjykatës së Apelit Korçë edhe ai i “Prokurorit” pranë kësaj prokurorie. Prokuroria znj. Rozeta Qirjaqi që ushtron detyrën e prokurores së vetme në këtë prokurori çmohet të caktohet përkohësisht në detyrën e Drejtueses, për një afat tre mujor. Në këto kushte vendi i saj si Prokurore, pranë Prokurorisë së Apelit Korçë është përkohësisht i lirë, për një afat prej tre muaj ose deri në përfundim të marjes formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për prokurorin znj. Irma Bali.

Në pikën 4 të nenit 47 të Ligjit 96/2016 parashikohet se: “ Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar...;” .

Bazuar në nenin 43 të ligjit 96 të drejtën për tu emeruar në Prokurorinë e Apelit e kanë: a) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose në prokurori të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë; b) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose prokurori të një niveli më të ulët dhe është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit;

Bazuar nga të dhënat e marra në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbi bazën edhe të propozimit të Komisionit të Karrierës, çmon se prokurori znj. Irena Çunoti përmbush kriteret ligjore të kërkuara nga ligji për të ushtruar funksionin si prokuror në prokurorinë e Apelit të Korçës. Kjo prokurore ka ushtruar funksionin e Prokurorit për gati 31 vjet, dhe është vlerësuar shumë mirë, në dy vlerësimet e fundit.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 59 pika 1 dhe 4 të ligjit 96 të vitit 2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “ Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë“ Këshilli i Lartë i Prokurorisë

V E N D O S I

1. Znj. Irena Çunoti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht të ushtrrojë funksionin e “Prokurores” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, në vend të Prokurores Rozeta Qirjaqi .

2. Pozicioni i prokurores znj.Rozeta Qirjaqi, Prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, do të plotësohet përkohësisht nga prokuroria znj.Irena Çunoti , nga data 22.02.2019-21.05.2019.
3. Të njoftohen me këtë vendim Prokuroria e Përgjithshme, prokuroria znj. Irena Çunoti, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së parë Korçë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
ANTONETA SEVDARI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR
GENTJAN OSMANI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
BESNIK CANI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**